



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
-KOMISIONI I KONKURENCËS-**

**VENDIM
nr. 437, datë 5.10.2016**

Për miratimin e rregullores “ Mbi procedurat e angazhimeve ”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Servete GRUDA | Zv/Kryetar |
| • Koço BROKA | Anëtar |
| • Iva ZAJMI | Anëtar |
| • Eduard YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 5.10.2016, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 45.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt - Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm:

VËREN SE:

1. Rregullorja është hartuar duke u përshtatur dhe përafruar Rregulloren e Këshillit (EC) nr 1/2003 datë 16 Dhjetor 2002 mbi implementimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit, Manualin e Procedurave, (Mars 2012) dhe njoftimi i Komisionit mbi praktikat më të mira për procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU (2011/C 308/06).

2. Kjo rregullore përafron legjislacionin shqiptar me atë europian në fushën e konkurrencës në zbatimin e rasteve kryesore kur angazhimet eliminojnë problemet e konkurrencës të identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës.

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi;

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda	Koço Broka	Iva Zajmi	Eduard Ypi
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R

RREGULLORE

“Mbi procedurat e angazhimeve”¹

Kreu I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.03.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

¹ Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1/2003 e datës 16 Dhjetor 2002 mbi implementimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit (OJ L 1, 4.1.2003, p. 1–25)(32003R0001) (neni 9); Manuali i Procedurave, (Mars 2012); Njoftimi i Komisionit mbi praktikën më të mira për procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU (2011/C 308/06)

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet në rastet kur angazhimet eliminojnë shqetësimet e ngritura të konkurrencës, te identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Vendimi me angazhime, paraqet angazhime të ofruara nga ndërmarrjet, të cilat janë detyruese, krijojnë siguri ligjore, rivendosin konkurrencën në treg dhe sigurojnë ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme.
2. Në rastet e marrjes së një vendimi me angazhime, nuk është e domosdoshme kryerja e procedurave të plota hetimore. Vendimet me angazhime nuk kërkojnë të zbatohen të gjitha hapat procedurale që do të zbatoheshin në rastin e një vendimi përfundimtar. Rastet e “zgjidhjes me angazhime” mund të sjellin një ndryshim me të shpejtë dhe efektiv në treg.
3. Angazhimet nuk përcaktohen nga Komisioni, por depozitohen vullnetarisht dhe vendosen vetëm pas diskutimit me palët objekt hetimi.
4. Procedurat me angazhime çojnë në marrjen e vendimeve me angazhime, të cilat pas miratimit bëhen detyruese për ndërmarrjet të cilave i ’u adresohet ky vendim si dhe çon në përfundimin e procedurave hetimore .
5. Megjithatë, diskutimet lidhur me angazhimet kanë edhe dis-avantazhe. Kjo sepse angazhimet mund të tërhiqen (të mos vendosen) deri në marrjen e një vendimi me angazhime, apo kur rezultojnë se angazhimet nuk janë të përshtatshme, dhe në këtë rast ekziston gjithmonë rreziku që procedurat hetimore lidhur me shkeljen e mundshme të konkurrencës, të vonohen në kohë, si pasojë e diskutimeve lidhur me angazhimet, të cilat rezultojnë jo të suksesshme. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të sigurohemi se procedurat hetimore do të vijojnë, deri në arritjen e përfundimit se angazhimet janë në gjendje që të zgjidhin shqetësimin e identifikuar të konkurrencës.
6. Vlerësimi, analiza ligjore dhe faktike në rastin e zgjidhjes së shqetësimeve të konkurrencës, nëpërmjet një vendimi me angazhime, krahasuar me një vendim përfundimtar, është më e shkurtër në kohë.
7. Një vendim me angazhime nuk është i mundur në rastet kur Autoriteti i Konkurrencës, e konsideron natyrën e shkeljes të tillë, që kërkon vendosjen e një gjobe. Gjithashtu, nuk zbatohet procedura me angazhime në rastet e marrëveshjeve të fshehta, për të cilat mund të zbatohet “Programi i lehtësimit nga gjobat”.
8. Një vendim me angazhime, zakonisht ka për qëllim që të çojë një shkelje anti konkurrese, drejt fundit dhe të rivendosë konkurrencën në treg. Angazhimet mund të jenë të papërshtatshme, nëse ndërmarrjet nuk kanë ndërprerë praktikën e tyre të prezumuar anti-konkurrese, para ose përgjatë hetimit të Autoritetit të Konkurrencës.
9. Dallimi ndërmjet një vendimi sipas nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.03.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), me vendimin sipas nenit 45 të këtij ligji për angazhimet, është sepse në rastin e parë zbulohet një shkelje, kurse në të dytin vendoset një angazhim detyrues, pa arritur në konkluzionin nëse ka patur apo jo një shkelje. Vendimi me angazhime sjell :
 - Miratimin e angazhimeve, të cilat bëhen detyruese për palët dhe janë subjekt i vazhdueshëm monitorimi dhe kontrolli për të siguruar zbatueshmërinë e tyre;
 - Përfundimin e procedurave hetimore të Autoritetit të Konkurrencës, të cilat në çdo rast mund të rifillojnë në rastet e parashikuara në nenin 20 të kësaj rregulloreje

10. Niveli i kërkuar i detajeve në një vendim me angazhime është më i ulët, krahasuar me një vendim ndalues (neni 4 dhe 9 ligjit nr. 9121, datë 28.03.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), ose vendim për kushte dhe detyrime. Megjithatë, Autoriteti i Konkurrencës, duhet të ketë në dispozicion fakte të mjaftueshme, për të kryer një vlerësim të shqetësimeve të konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës duhet të ketë arritur në përfundimin, se edhe pse mbi baza paraprake, mund të ketë ose mund të ketë patur një shkelje të rregullave dhe parimeve të konkurrencës të cilat i adresohen palëve nën hetim.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Ligj” nënkupton Ligjin nr.9121, datë 28.03.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar)
2. “Vendimi me Angazhime”, është një instrument zbatues i ligjit, me objektiv kryesor rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektivë.
3. “Vlerësim paraprak”, nënkupton informimin e ndërmarrjeve nga Autoriteti Konkurrencës lidhur me shqetësimet/problemet e konkurrencës.

Kreu II

Vendimet me angazhime

Neni 4

Fillimi i diskutimeve për dhënien e angazhimeve

1. Ndërmarrjet mund të kontaktojnë Autoritetin e Konkurrencës, në fazat e para të fillimit të procedurave hetimore dhe të shfaqin gatishmërinë e tyre për të hyrë në diskutime mbi angazhimet. Megjithatë, edhe në rastin kur raporti i hetimit i është dërguar palëve, angazhimet përsëri mund të pranohen.
2. Autoriteti ose ndërmarrja objekt hetimi, mund të vendosë në çdo moment gjatë procedimit të mos vazhdojnë diskutimet e tyre, në veçanti nëse Autoriteti nuk është i bindur për gatishmërinë e vërtetë të ndërmarrjes për të propozuar angazhime që do të adresojë shqetësimet e konkurrencës. Autoriteti, vazhdon normalisht procedurat hetimore për miratimin e një vendimi ndalimi.

Neni 5

Takimi paraprak

1. Autoriteti i Konkurrencës cakton një takim me palët nën hetim, të cilat shfaqin interes për të diskutuar lidhur me angazhime të mundshme. Në takimin, në të cilin marrin pjesë edhe anëtarët e Grupit të Punës, Autoriteti prezanton problematikat e shfaqura dhe të ngritura gjatë procedurave hetimore. Duke qenë se përshkrimi i rastit në takimin që bëhet, është baza kryesore për ndërmarrjen që të vendos, nëse do të depozitohet angazhime apo jo, kjo përmbledhje e shqetësimeve të konkurrencës duhet të jetë e përgatitur me kujdes të veçantë.
2. Edhe nëse shqetësimet e konkurrencës të ngritura nga Autoriteti, prezantohen vetëm verbalisht tek palët, ky prezantim duhet të jetë i mirë-strukturuar dhe ti lejojë palëve që të kuptojnë problematikat e ngritura.
3. Palëve duhet tu jepet mundësia që të pyesin në lidhje me shqetësimet e konkurrencës me qëllim që të jenë në gjendje që të raportojnë pastaj këto shqetësime/problematika tek organet e tyre vendimmarrëse.
4. Komisioni i Konkurrencës vendos nëse do të marrë një vendim me angazhime apo jo. Për këtë arsye është e rëndësishme të theksohet fakti se përgjatë diskutimeve mbi angazhimet potenciale, nuk ka një qëndrim përfundimtar.

Neni 6

Depozitimi i një oferte joformale me angazhime

1. Pasi palët janë njohur me shqetësimet/problematikat e konkurrencës përgjatë takimit të zhvilluar dhe nëse vendosin të ofrojnë angazhime, ato duhet të bindin Komisionin se kjo ofertë është serioze dhe e besueshme.
2. Për këtë qëllim, palët duhet të nënvizojnë elementët kryesorë të propozimit të angazhimeve. Kjo bëhet duke depozituar një propozim me elementët kryesorë të angazhimeve, dhe ndonjëherë edhe me një tekst i cili është drafti i parë i angazhimeve.
3. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson nëse angazhimet in-formale të propozuara i adresohen dhe zgjidhin shqetësimet/problemet e konkurrencës, dhe se ndërmarrja është seriozisht e interesuar të depozitohet angazhime formale të përshtatshme.

Neni 7

Përgatitja e vlerësimit paraprak

1. Autoriteti i Konkurrencës duhet të informojë ndërmarrjet lidhur me shqetësimet/problemet e konkurrencës nëpërmjet Raportit të Hetimit.

2. Raporti i Hetimit, përmbledh elementët kryesorë të rastit dhe identifikon shqetësimet e konkurrencës, të cilat kërkojnë nxjerrjen e një vendimi i cili përcakton ndalimin e shkeljes.
3. Vlerësimi paraprak që kryen Autoriteti i Konkurrencës varion rast pas rasti, në varësi të kompleksitetit të rastit.
4. Në rastet kur raporti i hetimit tashmë është përgatitur, për një rast të veçantë, nuk është e nevojshme të dërgohet një Vlerësim Paraprak, sepse në këtë rast vetë raporti i hetimit përbën Vlerësimin Paraprak. Kjo sepse raporti i Hetimit përmban një përmbledhje të fakteve kryesore si dhe një vlerësim mbi shqetësimet/problemet e identifikuar të konkurrencës.
5. Raporti i Hetimit/Vlerësimi nuk duhet të përmbajë vetëm diskutimet informale mbi angazhimet dhe angazhimet e ofruara nga palët, por edhe të specifikojë elementët kryesorë që kërkojnë për të eliminuar problemet/shqetësimet e konkurrencës dhe të përcaktojë se cilat çështje janë ende duke u diskutuar me palët.
6. Për ankimuesit, nxjerrja e Raportit të Hetimit/Vlerësimit nuk do të thotë se do të ketë të drejta proceduralë të caktuara. Ankuesi nuk ka të drejtën e ndonjë seance dëgjimore apo të marrë kopje jo konfidenciale të materialeve apo të ketë akses në informacionin e zotëruar. Qëllimi i vetëm është informimi formalisht i ndërmarrjes nën hetim, lidhur me shqetësimet/problematikat e konkurrencës. Ky vlerësim nuk publikohet dhe as do të bëhet i disponueshëm për palë të treta.
7. Megjithatë, në disa raste specifike, mund të jetë e këshillueshme që të informohet ankuesi lidhur me përmbajtjen kryesore të këtij raporti. Grupi i punës mund ta përdorë këtë rrugë, nëse shpreson se ankuesi do të jetë në gjendje që të sigurojë të dhëna të rëndësishme për diskutimet që do të vijojnë më pas dhe që lidhen me qëllimin e saktë të angazhimeve. Ky avantazh duhet të mendohet mirë duke e balancuar me riskun që mund të ketë në lidhje me ecurinë dhe dështimin e diskutimeve mbi angazhimet. Palët e treta nuk duhet të diskriminohen nëse ato ofrohen për të siguruar informacion.

Kreu III

Depozitimi i një teksti/dokument angazhimesh lidhur me testimin e tregut

Neni 8

Kuadri procedural

Formati i vendimeve mbi angazhimet

1. Pas marrjes së Raportit/Vlerësimit, ndërmarrjet nën hetim normalisht kanë një muaj kohë për të reaguar dhe për të depozituar një tekst/dokument propozime mbi angazhimet, që

duhen testuar në treg. Ky afat kohor mund të zgjatet, pas depozitimit të një kërkesë të arsyetuar të ndërmarrjeve nën hetim.

2. Ndërmarrja mund të depozitohet një përgjigje me shkrim, e cila duhet të merret parasysh kur draftohet vendimi përfundimtar mbi angazhimet

Neni 9

Përmbajtja e angazhimeve

1. Angazhimet duhet të lidhen me shqetësimet e identifikuar të konkurrencës. Për ato angazhime të cilat nuk lidhen me shqetësimet e konkurrencës ose nuk i plotësojnë ato, nuk pranohen nga Komisioni. Palët mund të ofrojnë angazhime të cilat kanë natyrë sjelljeje (p.sh. detyrim për të ofruar/furnizuar) ose natyrë strukturore (p.sh shitje të një pjesë të ndërmarrjes).
2. Angazhimet e sjelljes zakonisht kanë dis-avantazhin që ato kërkojnë kohë të gjatë për tu monitoruar.
3. Në parim, angazhimet e ofruara duhet të jenë proporcionale, d.m.th ato të mos shkojnë përtej asaj ç'ka është e nevojshme për të rregulluar/ndrequr shqetësimet e konkurrencës. Megjithatë, në krahasim me përqendrimet duhet të kihet parasysh fakti se angazhimet depozitohen vullnetarisht në të kundërt të përqendrimeve të cilat vendosen nga Komisioni.
4. Komisioni në çdo rast duhet të verifikojë se:
 - a) angazhimet janë të mjaftueshme për të adresuar shqetësimet e konkurrencës dhe
 - b) ndërmarrja ka ofruar angazhimet e duhura.
5. Megjithatë, është e rëndësishme për zbatueshmërinë e angazhimeve që ato të jenë të qarta dhe të vetë ekzekutueshme. Kjo do të thotë se zbatueshmëria e tyre nuk duhet të varet nga vullneti i palëve të treta. Gjithashtu, duhet që procesi i zbatueshmërisë duhet të dizajnet në mënyrë të tillë që ndërmarrja të ketë nxitjen për ta zbatuar angazhimin në mënyrën e duhur. Angazhimet strukturore të cilat parashikojnë një afat kohor të përcaktuar për procedurat e strukturimeve dhe i jep administratorit të besuar të drejtën që të zhveshë/shesë biznesin respektiv duhet të ndiqen nga afër përderisa bëhet fjalë për një rast të caktuar ati konkurrues. Prandaj është në interesin e ndërmarrjes që të shesë/strukturojë biznesin brenda afatit kohor. Angazhime kontradiktore ose jo të plota, mund të rezultojnë në një dështim në eliminimin e shqetësimeve të konkurrencës dhe mund të jetë e vështirë që të korrigjohen në një fazë të mëvonshme. Megjithatë, Komisioni mund të rihapë procedura hetimore nëse një ndërmarrje vepron në kundërshtim me angazhimet.

6. Nëse është e nevojshme, administratori i besuar mund të caktohet për të asistuar Komisionin në zbatimin e angazhime (administrator monitorimi dhe/ose strukturor²).
7. Ka një rëndësi të veçantë që të regjistrohen dhe të mbahen rekorde/procesverbale të diskutimeve, duke marrë në konsideratë, në veçanti faktin që zbatimi i angazhimeve mund të ndodhë në një fazë të mëvonshme dhe kjo mund të kërkojë një interpretim të tekstit të angazhimeve, për të cilat regjistrimet e mbajtura do të ishin shumë të nevojshme. Kjo është shumë e rëndësishme, sidomos kur flitet për angazhime të cilat kanë natyrë sjelljeje, duke qenë se ato mund të vazhdojnë për disa vjet me radhë dhe mund të kërkojnë një kohë të gjatë për tu monitoruar.
8. Angazhimet finale duhet të firmosen nga ndërmarrjet në fjalë.

Neni 10

Kohëzgjatja e angazhimeve

1. Kohëzgjatja e angazhimeve mund të jetë e kufizuar në kohë. Angazhimet duhet të sigurojnë se një përmirësim i strukturës së tregut është arritur brenda afatit kohor të parashikuar. Kjo ndryshon nga tregu në treg, në varësi të reagueshmërisë së tregut ose të investimeve që kërkohen të kryhen për të realizuar këto përmirësime. Sërish, parimi i proporcionalitetit duhet të merret në konsideratë, d.m.th serioziteti i shkeljes dhe nevoja për të përshtatur efektet ashtu siç duhet.
2. Dispozita të tjera përfshirë edhe dispozita që parashikojnë zgjatjen e afatit kohor të angazhimeve zbatohen vetëm për rrethana të caktuara. Këto rrethana, të cilat janë të mundshme, ose të paktën të jenë të mundura të ndodhin, duhet të mirë përcaktohen që në fillim.

Neni 11

Testimi në treg i angazhimeve të dhëna

1. Në rastet kur Autoriteti i konsideron angazhimet e ofruara si të mjaftueshme, në përputhje me shqetësimet e ngritura të konkurrencës mund të kryejë edhe një testim të tregut lidhur me këto angazhime.
2. Autoriteti, ka të drejtë edhe jo zyrtarisht të testoj tregun apo të diskutojë angazhimet e ofruara, me palë të treta të interesuara rreth çështjes.
3. Në rast se Autoriteti nuk është i bindur se angazhimet e ofruara “*prima facie*/ në pamje të parë” i adresohen shqetësimeve të identifikuar të konkurrencës, nuk duhet të vazhdojë me përgatitjen e testimit të tregut, por të diskutojë lidhur me ecurinë e procedurës së mëtejshme.

² Të drejtat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë përcaktuar në Kreun 5 “Kërkesat për zbatimin e angazhimeve” të Udhëzimit “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve”

Kreu IV

Testimi i tregut

Neni 12

Forma e testimit të tregut

1. Autoriteti mund të publikojë në faqen zyrtare të institucionit, një përmbledhje të shkurtër të çështjes dhe përmbajtjes kryesore të propozimit të angazhimit dhe ti japë palëve të treta një mundësi, që të paraqesin vërejtjet e tyre, para se të mund të miratohen vendimet sipas nenit 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar). Ky është i ashtuquajturi “testim i tregut”.
2. Për këtë qëllim, "njoftimi për testimin e tregut" botohet në faqen zyrtare, dhe përmban një përmbledhje të shkurtër të çështjes (sjelljes së dyshuar dhe shkeljes së dyshuar të ligjit të konkurrencës) dhe përmbajtjes kryesore të propozimit mbi angazhimet, duke respektuar detyrimet mbi sekretin profesional. Përmbledhja duhet t'i lejojë palët e treta të kuptojnë elementet thelbësore të angazhimeve dhe se si eliminohen shqetësimet e konkurrencës të identifikuara nga Autoriteti.
3. Njoftimi për testimin e tregut, zakonisht fton palët e treta të interesuara për të "paraqitur vërejtjet e tyre" mbi angazhimet e propozuara.
4. Teksti i plotë i propozimit të angazhimit në versionin e saj jo-konfidencial , publikohet në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës.
5. Nëse rasti, është i bazuar në një ankesë, testimi i tregut duhet të dërgohet tek ankuesi. Komisioni ka të drejtë të dërgojë njoftimin edhe tek palët e tjera të treta të interesuara, që dihet se janë të shqetësuara të njihen me rezultatin e rastit (p.sh. palë të treta të pranuar në procedurë, shoqatat e konsumatorëve etj) dhe duke kërkuar komentet e tyre, në mënyrë të qartë. Kjo siguron, përfshirjen e plotë të ndërmarrjeve në këtë proces.
6. Në testimin e tregut, Komisioni duhet të ftojë palë të treta të interesuara të paraqesin observacionet e tyre, brenda një afati kohor të caktuar, i cili nuk mund të jetë më pak se një muaj.

Neni 13

Informacion për diskutim të mëtejshëm

1. Ndërmarrjet, të cilat ofrojnë angazhime, duhet të informohen për rezultatet e testimit të tregut. Kjo mund të bëhet me gojë ose me shkrim. Identiteti i palëve të treta nuk mund të zbulohet .

2. Pas marrjes së përgjigjeve ndaj testimit të tregut, duhet të organizohet një takim me palët.
3. Detyrimi për të kryer një testim të tregut, nuk duhet të keqkuptohet si kërkim i miratimit nga tregu, të angazhimeve të propozuara. Testimi i tregut nuk është një sondazh i opinionit, që përcakton fatin e këtyre angazhimeve. Komisioni mund të marrë një vendim me angazhime, edhe në rastet në të cilat pjesëmarrësit në testimin e tregut, kanë kërkuar refuzimin e angazhimeve të propozuara nga palët. Testimi i tregut në vendimet e angazhimit, shpesh i siguron Komisionit, informacione të dobishme se si angazhimet mund të përmirësohen.
4. Në varësi të rastit, modifikime të rëndësishme apo më pak të rëndësishme mund ti bëhen angazhimeve pas testimit të tregut. Këto ndryshime, duhet të diskutohen me palët. Ndryshimet e vogla ("teknike") në tekstin e angazhimit nuk kërkojnë hapa të rinj procedural.
5. Gjithashtu, nuk është i nevojshëm një testim i ri i tregut, në rastin e angazhimit të rishikuar përveç nëse, rishikimi i angazhimeve është thelbësor. Një ndryshim është thelbësor vetëm nëse ndryshon natyra apo qëllimi i angazhimeve .

Neni 14

Ankuesit

Në rastin e një ankese formale, para miratimit të vendimit me angazhime, ankuesi informohet se, Komisioni ka pranuar çka ka konsideruar angazhime të përshtatshme dhe për këtë arsye nuk ka baza të mëtëjshme për të vazhduar me rastin.

Kreu V

Miratimi i vendimit

Neni 15

Përmbajtja e vendimit me angazhime

1. Grupi i punës harton një draft-vendim me angazhime në bazë të vlerësimit paraprak. Vendimi me angazhime duhet të përmbajë një përmbledhje të fakteve të çështjes dhe vlerësimit ligjor. Vendimi me angazhime duhet të përmbajë shqetësimet e identifikuara të konkurrencës. Vendimi duhet të përshkruajë angazhimet e depozituara nga ndërmarrja/ndërmarrjet, të shpjegojë pse angazhimet zgjidhin shqetësimet e identifikuara të konkurrencës në mënyrë proporcionale. Gjithashtu, mund të ketë dispozita në lidhje me arsyetimin se përse nuk është e nevojshme vendosja e një gjobe.

2. Një vendim me angazhime zakonisht është më i shkurtër se një vendim ku konstatohet një shkelje e rregullave të konkurrencës. Megjithatë, kjo varion rasti pas rasti, në varësi të kompleksitetit të rastit.

Neni 16

Ankesat dhe Informimi i ankuesit

1. Në rastet kur pas marrjes së një vendimi me angazhime, depozitohet një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës, dhe institucioni vihet në dijeni në lidhje me argumente të reja, të cilat kërkojnë një rivlerësim të situatës, mund të kryhet një rivlerësim i rastit. Pas këtij rivlerësimi, ankuesit i dërgohet një letër ku shpjegohen arsyet e marrjes së një vendimi të tillë.
2. Nëse ankuesi nuk ka bërë ndonjë koment, atëherë ankesa konsiderohet se është tërhequr. Nëse ankuesi ka bërë komente, por këto komente nuk janë aq thelbësore dhe të rëndësishme, sa të çojnë në rivlerësimin e angazhimeve, atëherë procedura mund të vazhdojë pa ndonjë ndryshim në angazhimet e dhëna dhe ankesa do të duhet të refuzohet.
3. Refuzimi i ankimit bëhet menjëherë pas nxjerrjes së vendimit me angazhime që përshkruan, se pas angazhimeve, nuk ka më arsye për Autoritetin e Konkurrencës që të vazhdojë procedurat hetimore. Nëse ankesa parashtrohet me shumë argumente se sa ato të trajtuara në vendimin me angazhimet, atëherë është i nevojshëm shpjegimi i arsyeve për refuzimin e ankesës.

Neni 17

Publikimi i vendimit

Vendimi me Angazhimet, është i nevojshëm të publikohet në përputhje me nenin 47 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Neni 18

Implementimi i angazhimeve

1. Në këndvështrimin e konkurrencës, zbatimi i suksesshëm i vendimit me angazhime, pas miratimit të vendimit, është vendimtare për suksesin përfundimtar të ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës në treg. Për këtë arsye, është shumë i rëndësishëm monitorimi i kujdesshëm i procesit të zbatimit të angazhimeve të dhëna.
2. Monitorimi që do të kryhet varet nga natyra e angazhimeve. Në shumicën e rasteve, por dhe në veçanti, kur bëhet fjalë për angazhime strukturore, angazhimet duhet të parashikojnë që duhet të caktohet një administrues i besuar, menjëherë pas miratimit të vendimit me angazhime. Administratori i besuar, duhet të jetë i pavarur dhe i kualifikuar për të kryer detyrën e monitorimit. Ai do të monitorojë në mënyrë të

detajuar hapat e ndryshme të zbatimit të angazhimeve dhe i raportojnë rregullisht mbi këtë, Komisionit të Konkurrencës.

3. Në rastet e angazhimeve strukturore , duhet të verifikohet fakti nëse blerësi plotëson të gjitha kriteret e vendosura në vendimin me angazhime. Autoriteti i Konkurrencës duhet të mbikëqyr këtë proces dhe të qëndrojë në kontakt të rregullt me administratorin e besuar dhe ekipin e tij, në mënyrë që të shmangë ose të adresojë çfarëdolloj problemi të mundshëm, i cili sjell pasoja për angazhimet dhe i bën ato më pak efektive se sa janë parashikuar.

Neni 19

Avantazhet e vendimeve të angazhimeve

1. Së pari është rivendosja e konkurrencës së shpejtë dhe efektive në treg, në dobi të konsumatorëve dhe interesit publik.
2. Së dyti është efektiviteti, pasi vendimi me angazhime nuk bazohet në kryerjen e hetimeve në shkallë të plotë dhe nuk arrijnë përfundime mbi faktet e rastit apo zbatimin e ligjit. Për më tepër, ata zakonisht përfshijnë më pak hapa procedurale, duke lejuar përdorim më të përshtatshëm të burimeve të autoritetit.
3. Së treti, Vendimi me angazhime preferohet edhe nga ndërmarrja nën hetim, për vetë procedurën më të shpejtë që ndiqet, për mungesën e një vendimi sanksionues mbi gjetjen e një shkelje të rregullave të konkurrencës, si edhe për faktin se angazhimet janë depozituar vullnetarisht dhe nuk imponohen.

Neni 20

Rihapja e procedurave hetimore

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të një kërkesë ose me nismën e tij, mund të rihapë procedurat hetimore në rastet :

1. Kur janë shfaqur fakte të reja në lidhje me rastin;
2. Kur ndërmarrjet në fjalë veprojnë në kundërshtim me angazhimet e dhëna;
3. Kur vendimi është bazuar në informacion jo të plotë, jo të saktë ose të rremë të ofruar nga palët.

Neni 21

Hapat themelore të procedurës së angazhimit

Hapat themelore të procedurës së angazhimit zakonisht përfshijnë:

1. Depozitim nga ndërmarrja të angazhimeve të propozuara me qëllim adresimin e shqetësimeve të ngritura nga ana e Autoritetit të Konkurrencës;

2. Diskutime midis ndërmarrjes dhe Autoritetit të Konkurrencës për të propozuar angazhimet dhe ndryshimet e mundshme në propozim;
3. Përfshirja e mundshme e palëve të treta ose ankuesit të interesuar;
4. Një vlerësim përfundimtar i propozimit, zakonisht i ndjekur nga një vendim formal.

Neni 22

Mekanizmat e monitorimit

Mekanizmat e monitorimit efektiv mund të përfshijnë:

1. Monitorimi i realizimit të angazhimeve nga vetë Autoriteti i Konkurrencës ex-officio;
2. Monitorimi bazuar në një ankesë ose informacion të marrë nga pjesëmarrësit në treg, që ofrojnë informacion në lidhje me mos-përputhjet e mundshme me angazhimet (me nismën e tyre ose me kërkesë të Autoritetit të Konkurrencës) ;
3. Raportimi i rregullt nga ndërmarrjet të cilat janë palët pjesëmarrëse të Vendimit me Angazhime pranë Autoritetit të Konkurrencës;
4. Monitorimi bazuar në bashkëpunimin me entet rregullatorë dhe / ose organet e tjera publike;
5. Monitorimi bazuar në bashkëpunimin me administratorët e besuar dhe/ose ekspertët e jashtëm ;
6. Kombinim i mjeteve të mësipërme.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.